



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1671/23

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Eurosig”sh.a me seli ne rr.”2 Korriku” nr.4, ndaj debitorit “Telekomi i Kosovës“ sh,a me seli ne Prishtinë lagja Dardania-Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkalles se Parë–Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.514/22 të datës 31.10.2022, me datën 06.07.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e debitorit “Telekomi i Kosovës “ sh,a me seli ne Prishtinë lagja Dardania-Bulevardi “Dëshmoret e Kombit” ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles se Parë–Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.514/22 të datës 31.10.2022, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës –Dhoma e shkalles se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.514/22 të datës 31.10.2022, ne pjesën e I te dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si te bazuar propësimin e debitorit Telekomi i Kosovës sh.a dhe ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbartimor P.nr.2687/20 dt.19.10.2020 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor ne shumen prej 294,424.53 euro dhe kamatën për pjesën e detyrimit kryesor ne shumen prej 57,021.00 euro. Ne pjesën e II te dispozitivit ka lënë ne fuqi pjesën tjetër te urdhrin përmbartimor P.nr.2687/20 dt.19.10.2020 te lejuar nga përmbartuesi privat Afet Mjeku me te cilin është caktuar përmbartimi sa i përket shpenzimeve te procedurës përmbartimore dhe kamatëvonesës mbi pjesën e detyrimit kryesor ne shumen prej 237,403.53 euro. Ndërsa ne pjesën e III te dispozitivit ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbartimore te kreditorit Kompania e Sigurimeve “Eurosig” ndaj debitorit Telekomi i Kosovës sh.a sipas urdhrin përmbartimor P.nr.2687/20 dt.19.10.2020 i lejuar nga përmbartuesi privat Afet Mjeku, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë, për detyrimin kryesor ne shumen 294,424.53 euro për shkak te përmbushjes se detyrimit kryesor dhe kamatën për pjesën e detyrimit kryesor ne shumën prej 57,021.00 euro.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës procedurale dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkalles së dytë ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar, aktvendimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në shkallë të parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 19.10.2020 ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.029935 dt.04.03.2020, nr.029979 dt.06.03.2020, 030178 dt.07.04.2020, 030177 dt.07.04.2020, nr. 030425 dt.06.05.2020, nr. 030427 dt.06.05.2020, nr. 030707 dt.03.06.2020, nr.030711 dt.03.06.2020. Përmbareuesi Privat Afet Mjeku nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbaremore P.nr.2687/20 dt.19.10.2020, ka lejuar përmbaremoren, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga faturat të paguaj shumën prej 294,424.53 euro, me kamatëvonesë prej 8% vjetore llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër aktvendimit për lejimin e përmbaremoren, debitori me datën 27.10.2020, ka paraqitur prapësim, me deklarin se e konteston urdhrin përmbaremore duke theksuar se kërkesa e kreditorit është në tërësi e pabazuar sepse dokumenti në bazë të cilit është iniciuar procedura nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbareueshmërisë, në rastin konkret nga kreditori nuk është respektuar neni i kontratës ku parasheh që në rast kontesti zgjidhja të behet me marrëveshje të ndërsjellë mes palëve, prandaj me rastin e vendosjes lidhur me prapësimin e debitorit kërkon nga gjykata ta merr parasysh këtë fakt, andaj, i propozon që gjykata e shkalles së parë ta pranoj prapësimin e debitorit, të abrogoj urdhrin përmbaremore dhe ta obligoj kreditorin të bart shpenzimet e përmbaremoren.

Përgjigje në prapësimin e debitorit me datën 23.11.2020 ka ushtruar kreditori me Arsyetimin se e kreditori me rastin e inicimit të procedurës ka prezantuar të gjitha faturat origjinal, shton se kreditori vërteton se një pjesë e faturave janë paguar për çka konfirmon nga lista e faturave të paguara ndërsa një pjesë e detyrimeve sipas listës së bashkangjitur kësaj përgjigje është e papaguar, andaj propozon që gjykata ta aprovoj pjesërisht prapësimin e debitorit, për pjesën prej 57,021.00 euro dhe ta refuzoj prapësimin debitorit për pjesën e obligimit prej 237,403.53 euro për të cilën shumë pala debitore pohon ekzistimin e këtij obligimi.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.514/22 dt.31.10.2022, me të cilin e ka pranuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin për përmbarim si dhe e ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbarimore, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Gjykata ka arsyetuar se një pjesë e detyrimeve prej 57,021.00 euro nga debitori është përmbushur para inicimit te procedurës ndërsa pjesa tjetër e mbetur e detyrimit prej 237,403.53 euro debitori e ka përmbushur pas datës se inicimit te procedurës andaj ne këtë kuptim edhe ka vendosur për përfundimin pjesërisht te procedurës përmbarimore ndërsa debitori ka obligim për pagesën e kamatëvonesës mbi shumën e detyrimit kryesor 237,403.53 euro si dhe shpenzimet e procedurës, duke vendosur kështu si ne dispozitiv te aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 te LPP, pra janë ne mospajtim me dispozitat ligjore.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Përkritazi kësaj çështje edhe kjo gjykatë vlerëson se ne baze te shkresave te lendes, pohimit te kreditorit ne përgjigjen ne ankesë, parashtrësës se debitorit dorëzuar Gjykatës Themelore ne Prishtinë për Gjykatën e Apelit me datën 21.02.2021 dhe Gjykatës Komerciale me datën 25.10.2022 përmes se cilës ka njoftuar se ka përmbushur ne tërësi detyrimin ndaj kreditorit, prandaj me te drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur për përfundimin e procedurës përmbarimore sa i përket përmbushjes se detyrimit kryesor. Sipas ekspertizës se bërë nga Prof. Aziz Berisha –ekspert për Sigurime, Akuaristikë dhe çështje Ekonomike-Financiare rezulton se debitori mbetet ne obligim ndaj kreditorit për pagesën ne emër te kamatëvonesës prej 8% mbi shumën e detyrimit kryesor prej 237,403.53 euro, e kjo për shkak te vonesës ne përmbushjen e detyrimit për arsye se këtë detyrim debitori e ka përmbushur pas inicimit te procedurës përmbarimore nga kreditori e kjo bazuar ne transaksionet bankare dhe atë te datës 23.11.2021 për shumën prej 59,563.98 euro, dt.07.12.2021 për shumën prej 59,589.81 euro, dt.19.01.2022 për shumën prej 59,073.21 euro, dt.30.12.2021 për shumën prej 59,176.53 euro, qe ne total kapin vlerën prej 237,403.53 euro. Edhe Gjykata e shkallës së dytë analizoi pretendimet e debitorit ne lidhje me kamatëvonesën por vlerësoi se te njëjtat mbesin te paargumentuara sepse nga propozimi për përmbarim kreditori ka kërkuar edhe kamatëvonesën prej 8% ndërsa bazuar ne nenin 382 par.1 parashihet qe “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit

kryesor, edhe kamatën” ndersa par.2 parasheh qe “Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, per çka gjykata e shkallës se dytë e refuzon ankesën e debitorit si te pabazuar ndërsa aktvendimin e shkalles se parë e vërteton.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.1671/23, me datë 06.07.2023.

Gjyqtari
Ramush Bardiqi